Kronikë

# Vetëplagosja e 36-vjeçarit në Vlorë, policia gjen pistoletën, ishte fshehur mes luleve (VIDEO)

*I plagosuri me pistoletë dhe shoku i tij që e ndihmoi për të fshehur armën janë arrestuar të dy nga policia.*

■ Vlorë/ Shkoi në spital pasi vetëplagos me armë, arrestohet 36-vjeçari së bashku me shokun! Fshehën armën dhe nuk kallëzuan ngjarjen




Redaksia
4 Tetor, 11:56 | **Përditesimi: 4 Tetor, 12:32**

Share

Policia e Vlorës ka gjetur pistoletën me të cilën u vetëplagos një ditë më parë 36-vjeçari, Olsi Alisinanaj

Pistoleta model "Ekol Special" ishte fshehur mes luleve nga shoku i të vetëplagosurit Gerti Meto, 42 vjeç.

Po kështu u sekuestrua edhe gëzhoja në vendin e ngjarjes, në lagjen "Hajro Çakëri".



LEXO EDHE:
**Berisha tha se do të mbështesin kandidatë të pavarur, PD e Vlorës del kundër: Emrin e zgjedhin forumet tona**

Ngjarja u zbulua pasi uniformat blu kqyrën pamjet e kamerave të sigurisë në zonë.

I plagosuri dhe shoku i tij që fshehu armën janë arrestuar të dy nga policia. 36-vjeçari u paraqit në spital për të marrë mjekim dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

**Njoftimi i Policisë së Vlorës:**

*Në vijim të veprimeve hetimore, në kuadër të ngjarjes së ndodhur më datë 03.10.2025, në qytetin e Vlorës, ku një 36-vjeçar, O. A., u vetëplagos me armë zjarri dhe shoku i tij, G. M., pas ngjarjes fshehu armën e zjarrit, shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë kanë vijuar veprimet për gjetjen e armës së zjarrit, tip pistoletë, të dyshuar të përdorur në ngjarje.*

*Arma e zjarrit e cila posedohej pa leje, e markës Ekol Special, u gjet në lagjen "Hajro Çakërri", Vlorë, në një rrugicë, e fshehur mes luleve, dhe u sekuestrua së bashku me një gëzhojë të gjetur në vendin e ngjarjes. Materialet shtesë do t'i referohen Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.*

V.GJ /Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Vlore veteplagosje Olsi Alisinanaj Gerti Meto

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 4 Tetor, 20:56
**PD pritet të mbështesë kandidatë të pavarur në 6 Bashki, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

## Lajme të tjera



Vlorë/ Zjarr i madh në Shën Andrea, forcat zjarrfikëse mbërrijnë në vendngjarje (VIDEO)
4 Tetor, 20:29



Sarandë/ Dyshohet se u dërgoi mesazheve 2 shoqeve të vajzës së tij, 50-vjeçari nën hetim për ngacmim seksual
4 Tetor, 12:40



U raportua i zhukur nga familjarët pasi shkoi të marrë pensionin, gjendet 93-vjeçari në Delvinë
4 Tetor, 09:22



Flamurtari luan sot në kryeqytet, vlonjatët projektojnë ndryshimin e trajnerit! Kontaktojnë ish-in e Vllaznisë
4 Tetor, 08:49



Revista 'Journée Mondiale': Zbuloni mrekullitë e Parkut Arkeologjik të Butrintit
4 Tetor, 08:42



Vlorë/ Banorët e 4 fshatrave kundër prishjeve të IKMT-së, mblidhen në 'Kuvendin Komunitar të Krahinës': Po na merren tokat për resorte
Armand Xhelili
3 Tetor, 21:45



Nga 100 deri në 5000 lekë, miratohen tarifat, tuneli i Llogorasë bëhet me pagesë! Lista e mjeteve që përjashtohen nga pagesa
3 Tetor, 18:12



Shkencëtarja Aseda Tena rikthehet në Vlorë: Mjekët shpëtuan nënën time nga kanceri i gjirit! Po punoj për binjakëzimin e spitaleve shqiptare me ato amerikane
Armand Xhelili
3 Tetor, 17:13



Vlorë/ Shkoi në spital pasi vetëplagos me armë, arrestohet 36-vjeçari së bashku me shokun! Fshehën armën dhe nuk kallëzuan ngjarjen
3 Tetor, 14:57



Vlorë/ Përplasen dy makina në Transballkanike, vetëm dëme materiale. Aksidenti shkakton trafik në qarkullim
3 Tetor, 14:32



Vlorë/ Gjenden mbetje kockore në Tërbaç, dyshohet për kafkë njerëzore!
3 Tetor, 14:09



"Night"/ U kap me doza kokaine dhe kanabisi gati për shitje, arrestohet 35-vjeçari nga Tirana në Himarë (VIDEO)
3 Tetor, 11:43



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje